STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 23 maj 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON 2.6 MILIARDE DOLLARE SHTESE NE FONDE FEDERALE PER RIMEKEMBJEN DHE QENDRUESHMERINE E MTA-së PAS SENDIT (SANDY)

E çon shumën gjithsej në 3.79 miliardë dollarë

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Administrata Federale e Tranzitit (Federal Transit Administration) (FTA) ka caktuar 2.6 miliardë dollarë shtesë në fonde të ndihmës për katastrofën për Autoritetin e Transportit Metropolitan (Metropolitan Transportation Authority) (MTA) për përpjekjet e rimëkëmbjes nga super stuhia Sendi (Sandy).

Fondet, të vendosura në dispozicion nëpërmjet Programit të Ndihmës së Emergjencës (Emergency Relief Program) të Administratës Federale të Tranzitit (Federal Transit Administration) (FTA), përfshijnë pothuajse 898 milionë dollarë të caktuara për të ndihmuar MTA me projekte të qëndrueshmërisë për të ndihmuar në sigurimin se pasuritë e tranzitit janë më shumë të afta që t'u bëjnë ballë katastrofave të ardhshme. Këto projektet të qëndrueshmërisë synojnë mbrojtjen e gjithshkaje, nga trenat dhe autobusat tek stacionet, tunelet dhe kantieret nga vërshimet e stuhisë dhe përmbytja.

"Vazhdojmë të punojmë së bashku me partnerët tanë federalë për të siguruar të gjitha burimet e disponueshme për të rindërtuar infrastrukturën e tranzitit të Nju Jorkut (New York), e cila drejton ekonominë e të gjithë rajonit," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Por është më shumë se thjesht rindërtim. Duhet të përkushtohemi ndaj ndërtimit të një sistemi më të fortë, më të qëndrueshëm që mund t'u bëjë ballë stuhive të ardhshme dhe t'u sigurojë 8.5 milionë udhëtarëve të përditëshëm një rrjet transporti publik të fortë që mund të japë shërbimin tek i cili varen çdo ditë."

"Jemi mirënjohës për ndihmën federale që kemi marë në mënyrë që të ecin përpara me projekte thelbësore për të mbajtur metronë të sigurtë dhe të qëndrueshme për vite me rradhë," tha Drejtori Ekzekutiv i Përkohëshëm i MTA-së Tomas F. Prendergast (Thomas F. Prendergast). "Këto fonde do të përfshihen në Ndryshimin e Programit të Kapitalit (Capital Program Amendment) tonë të ardhshëm që do të përshkruajë sesi do t'i përdorim këto fonde më së miri për të rindërtuar dhe fortifikuar të gjithë sistemin tonë të tranzitit."

Njoftimi i sotëm për 2.6 miliardë dollarë në ndihma të katastrofës e çon shumën gjithsej të caktuar për veprimtari të lidhura me Sendin (Sandy) në 3.79 miliardë dollarë, burime thelbësore për të ndihmuar në rimëkëmbjen në vazhdim. MTA më parë kishte marë pothuajse 1.2 miliardë dollarë në fonde nga Administrata Federale e Tranzitit (Federal Transit Administration) (FTA) për punën e riparimit dhe të ndihmës ndaj katastrofës të filluar nga Tranziti i Qytetit të Nju Jorkut (New York City Transit), Hekurudha e Veriut e Metrosë (Metro-North Railroad), Hekurudha e Long Ajlënd (Long Island Rail Road) dhe seksione të tjera të MTA-së, si dhe 3 milionë dollarë nga Agjencia Federale e Administrimit të Emergjencave (Federal Emergency Management Agency) (FEMA) për Urat dhe Tunelet e MTA-s (MTA Bridges and Tunnels).

Fondet për rimëkëmbjen dhe qëndrueshmërinë ndaj Sendit (Sandy) deri më 23 maj 2013 për MTA janë si më poshtë:

Caktimi fillestar	193,893,898 dollarë
Caktimi më 3/29	1,000,415,662 dollarë
Caktimi i sotëm për rimëkëmbje	1,702,462,214 dollarë
Caktimi i sotëm për qëndrueshmërinë	897,848,194 dollarë
Fondet gjithsej të caktuara sot	2,600,310,408 dollarë
FONDET GJITHSEJ DERI ME SOT	3,794,619,968 dollarë

Javën e kaluar, Guvernatori Kuomo (Cuomo) njoftoi se shërbimi në linjën Rokëuej A (Rockaway A) të dëmtuar nga stuhia do të rifillojë më 30 maj, pas një përpjekje gjashtë-mujore për të rindërtuar 1,500 këmbë të shinave që i kishte marë uji, për të zëvendësuar milje të kabllove të sinjalit, korrentit e komunikacioneve dhe për të rindrequr dy stacione që u përmbytën plotësisht.

Tranziti i Qytetit të Nju Jorkut i MTA-së (MTA New York City Transit) ka krijuar tashmë një Seksion të Rimëkëmbjes dhe Qëndrueshmërisë pas Sendit (Sandy Recovery and Resiliency Division) të ri, të përkushtuar për nisjen, çuarjen përpara dhe administrimin e rindërtimin nga Sendi (Sandy), që do të kërkojë vite të ndërtimit dhe mbikqyrjes së kujdesshme të miliarda dollarëve në ndihmë federale. Planet do të kërkojnë mbrojtjen e stacioneve, centraleve të ajrimit, tubave nën lumë, tuneleve, shinave në

nivelin rrugor, sinjaleve, mjediseve dhe kantiereve për trenat, nënstacioneve të korrentit të tërheqjes, pjesëve të çelësave të qarkut, mjediseve për autobusat, kullave të trenave dhe zonave publike. Qëllimi është që të mbrohen të gjitha pikat ku sistemi i metrosë mund të përmbytet gjatë një stuhie.

Hekurudha e Veriut e Metrosë e MTA-së (MTA Metro-North Railroad) dhe Hekurudha e Long Ajlënd e MTA-së (MTA Long Island Rail Road) gjithashtu pësuan dëme të konsiderueshme nga super stuhia Sendi (Sandy) dhe puna vazhdon në të dyja hekurudhat për të forcuar sistemet e tyre të shinave, sinjaleve dhe korrentit për t'u mbrojtur ndaj niveleve të larta të ujit në stuhitë e ardhshme. Urat dhe Tunelet e MTA-së (MTA Bridges and Tunnels) është duke studjuar sesi të mbrojë më mirë elementet thelbësore gjithashtu dhe është duke zëvendësuar pajisje e materiale që janë në rrezik me të madh të prishjes në tunelet Hju L. Keri (Hugh L. Carey) dhe Kuins Midtaun (Queens Midtown), të cilët u përmbytën të dy gjatë stuhisë. Përveç kësaj, Urat dhe Tunelet (Bridges and Tunnels) do të zhvillojë një studim, në përputhje me rekomandimet e Komisionit NYS 2100, për të analizuar se ç'farë nevojitet për të mbajtur të dyja urat e Rokëuej (Rockaway) në gjendjen më të lartë të ndreqjes së mirë, veçanërisht gjatë ndodhive të motit ekstrem. Urat Marin Parkuej-Xhill Hoxhis Memoriëll (Marine Parkway-Gil Hodges Memorial) dhe Kros Bei Veterëns Memoriëll (Cross Bay Veterans Memorial) u prekën rëndë të dyja nga erërat e forta gjatë uraganit Irenë (Irene) dhe super stuhisë Sendi (Sandy) dhe nga përmbytja gjatë Sendit (Sandy).

Ndërsa ndreqjet e përkohëshme e kanë mbajtur në punë shumicën e rrjetit të MTA-së, do të duhen vite për të skicuar dhe zbatuar masat e përherëshme të rimëkëmbjes. Sistemi i MTA-së pësoi një dëm të vlerësuar në 4.755 miliardë dollarë ndërsa linjat e hekurudhës dhe të metrosë, tunelet e automjeteve, stacionet e metrosë dhe pajisjet e korrentit dhe të sinjaleve u përmbytën me ujë të kripur gërryes gjatë Sendit (Sandy).

Përpara paraqitjes së kërkesave për marrjen e fondeve të sapo-njoftuara, MTA-së do t'i kërkohet të hartojë një listë të projekteve të kualifikohen dhe të punojë me FTA për të përmbushur kërkesat e kualifikimit. FTA do të caktojë fonde të tjera gjatë muajve të ardhshme.

# # #

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418